



## INFORMACIONE TË SHKURTRA MBI

# mbulimin dentar pediatrik

**Ju meritoni kujdes shëndetësor të përballueshëm.**

**"NY State of Health" është tregu zyrtar i planeve shëndetësore të Nju-Jorkut.**

## Regjistrohuni sot.



Në internet në adresën [nystateofhealth.ny.gov](https://nystateofhealth.ny.gov)



Me telefon në numrin  
1-855-355-5777  
TTY  
1-800-662-1220



Kontakttoni një asistent personal në adresën [info.nystateofhealth.ny.gov/findassistor](https://info.nystateofhealth.ny.gov/findassistor)

"NY State of Health" pajtohet me ligjet e zbatueshme federale dhe shtetërore për të drejtat civile dhe nuk diskriminon në bazë të racës, ngjyrës, kombësisë, besimit/fesë, gjinisë, moshës, gjendjes civile/familjare, gjendjes gjyqësore, dënimeve për vepra penale, identitetit gjinor, orientimit seksual, karakteristikave të predispozitave gjenetike, statusit ushtarak, statusit si viktimë e dhunës në familje dhe/ose hakmarrjes.

Buzëqeshja e fëmijës suaj jua ndriçon ditën. Duke u kujdesur për të tani mund të siguronit një të ardhme më të shëndetshme. Por ka disa gjëra që duhet t'i merrni parasysh **para se të regjistrohëni në një plan dentar pediatrik.**



## 1 Si mund të marr përfitime dentare pediatrike?

- Kushdo mund të marrë përfitime dentare pediatrike, qoftë nëpërmjet një "Qualified Health Plan" (QHP) ose një plani të pavarur dentar pediatrik.<sup>1</sup>
- Nëse u nevojitet mbulim edhe të rriturve edhe fëmijëve të familjes, keni alternativën e një plani dentar familjar, qoftë si pjesë e një QHP-je, ose si një plan të pavarur dentar familjar.<sup>2</sup>



## 2 Sa kushton mbulimi dentar pediatrik?

- Krahas primit mujor, planet dentare pediatrike mund të kenë një tarifë të zbritshme vjetore, të cilën duhet ta paguani para se plani të mbulojë shërbimet që nuk janë përfitime parandaluese. Tarifa e zbritshme ndryshon sipas planit.
- Planit dentar pediatrik mund të përfshijë edhe bashkëpagesa ose bashkësigurim për shërbimet e mbuluara.
- Të gjitha planet dentare pediatrike kanë një limit maksimal shpenzimi nga xhepi prej 350 \$ për fëmijë dhe 700 \$ për familje. Kjo është shuma maksimale që do të paguani gjatë çdo viti të caktuar mbulimi.

<sup>1</sup> Planet dentare pediatrike ndryshojnë sipas kontesë.

<sup>2</sup> Për më shumë informacion në lidhje me përfitimet dentare familjare, shihni Fletën informuese të mbulimit dentar familjar të "NY State of Health".

### 3 Cilat shërbime mbuloohen nga një plan dentar pediatrik?

- Përfitimet pediatrike përbëhen nga katër kategori kryesore: parandalues/bazë, rutinë, shërbim i specializuar dhe ortodonci e nevojshme mjekësore.
- Planet dentare pediatrike mbulojnë edhe kujdesin dentar emergjent.

Kategoria e shërbimit	Shembull i shërbimit
Parandalues/Bazë	Kontrolle, pastrime, fluorizim dhe vendosje e silanteve
Rutinë	Ekzaminime, grafi, mbushje të thjeshta dhe shkulje dhëmbi
I specializuar	Kirurgji orale, këllëfë, proteza, ura dhe heqje të nervit
Ortodonci	Aparate që ndihmojnë në drejtimin e dhëmbëve

- Shpenzimet nga xhepi në lidhje me këto shërbime dentare mund të ndryshojnë ndjeshëm në varësi të planit.
- Nuk ka kufizim përfitimi për shërbimet dentare për fëmijë apo periudha pritjeje për përfitimet pediatrike.

### 4 Si mund të gjej planin dentar pediatrik të përshtatshëm për fëmijën tim?

- Mjeti i krahasimit të planeve dentare i "NYSOH" ju lejon të krahasoni kostot dhe përfitimet e planeve të ndryshme dentare pediatrike.<sup>3</sup> Atë mund ta gjeni në faqen e internetit të tregut në adresën: <https://info.nystateofhealth.ny.gov/resource/dental-plan-comparison-tool>
- Faqja e internetit e tregut përmban edhe një mjet kërkimi të planeve shëndetësore dhe ofruesve të kujdesit shëndetësor të NYS, i cili do t'ju shfaqë një listë të ofruesve të kujdesit dentar që marrin pjesë në secilin plan. Atë mund ta gjeni në adresën: <https://pndslookup.health.ny.gov/>

<sup>3</sup> Gjatë kërkimit për plane dentare, sigurohuni të kërkoni informacion të përftimit pediatrik dhe jo për planet dentare familjare që përfshijnë informacion të përfitimeve për të rriturit.

Si usted habla un idioma diferente al inglés, los servicios de asistencia de idioma están disponibles gratis para usted. Llame al 1-855-355-5777 (TTY: 1-800-662-1220).

如果您使用的語言不是英語，您可以使用我們的免費語言支援服務。請致電 1-855-355-5777 (TTY: 1-800-662-1220)